



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 109

Prishtinë, më 7.5.2024, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Adnan Rustemi, Artan Abrashi, Dimal Basha, Arijeta Rexhepi, Erxhan Galushi, Hydajet Hyseni- Kaloshi, Blerta Deliu-Kodra, Hajdar Beqa dhe Driton Selmanaj.

Munguan: Besnik Tahiri.

Mbledhjen e kryesoi Adnan Rustemi, kryetar i Komisionit.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: Flutura Sogonjeva- Ekonomia Online, Ngadhjnim Halilaj-NDI dhe Çlirimtar Morina-T7

Stafi mbështetës i Komisionit: Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 4.4.2024;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin nr. 08/L-256 për falimentimin;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Projektligjin nr. 08/L-261 për mbrojtjen nga zjarri;
5. Planifikimi i vizitave në institucionet dhe agjencitë që bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 4.4.2024

Kryetari konstatoi se miratohet procesverbali nga mbledhja e mbajtur më datë 4.4.2024.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin nr. 08/L-256 për falimentimin

Kryetari, tha se për këtë projektligj janë mbajtur disa takime ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga institucione të ndryshme, ambasada dhe palët e interesit, ku është dhënë kontributi i tyre. Raporti përfshin gjithsej 42 amendamente, nuk ka ndonjë vërejtje në këtë raport dhe mund ta merrni fjalën, tha deputeti Rrustemi.

Meqë nuk pati diskutime, kryetari konstatoi se Komisioni me 7 vota për dhe një abstenim, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

1. Miratohet raporti me amendamente për Projektligjin nr. 08/L-256 për falimentimin;
2. Projektligjin nr. 08/L-256 për falimentimin dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim, sipas kompetencës në komisionet kryesore;
3. Amendamentet e miratuara janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 08/L-261 për mbrojtjen nga zjarri

Kryetari, tha se Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, ka paraqitur 17 amendamente. Komisioni për Legjislacion, në pajtim me nenin 76, paragrafi 8 të Rregullores së Kuvendit, vlerëson nëse projektligji dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm, sqaroi ai.

Meqë nuk pati diskutime, kryetari konstatoi se Komisioni, me 7 vota për dhe një abstenim, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr. 08/L-261 për mbrojtjen nga zjarri dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Planifikimi i vizitave në institucionet dhe agjencitë që bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion

Kryetari, tha se në planin e punës kemi përfshirë si aktivitet realizimin e disa vizitave në institucionet dhe agjencitë që bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion, për t'u njohur nga afër me punën dhe sfidat që përballen këto institucione. Në kuadër të kësaj janë planifikuar vizitat në Akademinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, Agjencinë për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, vizita nëpër burgje të Kosovës dhe institucione tjera, tha ai.

Driton Selmanaj, tha se pajtohem që të dalim në terren dhe të vizitojmë institucionet, për të cilat kemi rol monitorues, sidomos duhet menjëherë të fillojmë vizitat nëpër burgje dhe në qendrat e paraburgimit, dhe me theks të veçantë, disa pika për të cilat raporti i Departamentit Amerikan i Shtetit ka të gjetura, tha ai.

Dimal Basha, tha se vizita e parë të bëhet në Akademi të Drejtësisë, që të njoftohemi për së afërmi me punën e tyre dhe sfidat që ata ballafaqohen. Meqë jam kryesues i grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, pajtohem që të vizitohen burgjet dhe qendrat korrektuese, tha ai.

Hajdar Beqa, tha se i përkrah propozimet e deputetëve, që të vizitohen institucionet e cekura më lart, dhe pas raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit, përveç vizitave, të bëhet edhe bisedë me të burgosurit nëpër reparte të caktuara. Më pas, ai propozoi që të vizitohet edhe burgu në Gjilan, që të njoftohen se çka ka investuar Qeveria, meqë tani është një marrëveshje mes Danimarkës dhe Kosovës, që pritet të votohet në Kuvendin e Kosovës.

Dimal Basha, tha se së bashku me ekspertin e angazhuar, kemi përgatitur një agjendë të takimeve, dhe nëse ju keni ndonjë propozim shtesë, më pas mund të dakordohemi ta plotësojmë.

Driton Selmanaj, tha se në këto vizita do të ishte mirë të ishte kryetari dhe të gjithë deputetët, në mënyrë që të tregohet përkushtimi që Komisioni ka për mbikëqyrje të këtyre institucioneve.

Blerta Deliu-Kodra, tha se në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit, përmendet edhe dhuna në familje. Kjo është diskutuar gjatë edhe në Komision, por edhe në seance plenare. Ministrja e Drejtësisë është deklaruar se ka themeluar një task forcë, por raporti i DASH-it, thotë se pavarësisht që dhuna në familje është vepër penale, ka munguar ndëshshkueshmëria e Qeverisë dhe nuk është zbatuar ligji me efektivitet, gjithashtu përmend edhe dënimet të cilat janë të pamjaftueshme. Në këtë drejtim, do të ishte mirë të shohim edhe sfidat e gjyqësorit dhe çfarë ka bërë Ministria e Drejtësisë për task forcën, çfarë do të përfshijë dhe cilat janë hapat konkretë që kjo ministri ka bërë, për të parandaluar dhunën dhe nëse gjykatat janë të vetëdijshme në dënimet e ulëta, në rastet më të shpeshta të recidivistëve, tha ajo.

Meqë nuk kishte diskutime tjera, kryetari konstatoi se me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

V e n d i m

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, vendosi që të realizojë vizita nëpër institucione, për të parë nga afër zbatimin e Ligjit nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, Ligjit nr.08/L-132 për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe Kodit nr. 08/L-006 i Drejtësisë për të Mitur.

Komisioni do të mbulojë shpenzimet e ushqimit për anëtarët e Komisionit, stafin dhe ekspertët e angazhuar, sipas listës së pjesëmarrjes.

Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Pagesa, të bëjë ekzekutimin e pagesës për shpenzimet e ushqimit.

6. Të ndryshme

Në këtë pikë nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11:17.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Adnan Rrustemi,
Kryetar i Komisionit
